

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI SPITALOR DHE KLINIK UNIVERSITAR I KOSOVËS (SHSKUK)**

Për Aktivitetin e Prokurimit me numër të prokurimit 220-26-4259-1-1-1 dhe numër të brendshëm 220-026-044-1-1-1.

Sa i përket tenderit për "Furnizim me material për stroke nga LE"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

AGS Corporation Sh.P.K.

Dardania, Bll.1, Hy.3, Nr.5

10000 Prishtinë

+38344129152

Gazmend Boshnjaku

gazmendb@agskosovo.com

20.08.2026

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Shkumbin Asllani, Avokat

Rruga Mark Isaku L1/A5, +38344366007, shkumbin.asllani@inlexpartners.com

20.08.2026

(Nënshkrimi dhe vula)



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Autoriteti Kontraktues, SHSKUK – Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, më 04.06.2026 ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për stroke nga LE", me numër të prokurimit 220-26-4259-1-1-1 dhe numër të brendshëm 220-026-044-1-1-1.
2. Më 25.06.2026 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Informatat sqaruese lidhur me Dosjen e Tenderit.
3. Më 26.06.2026 është publikuar Formulari standard B54 për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.
4. Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave ka qenë më 06.07.2026, në orën 13:00, ndërsa Procesverbali i hapjes së tenderëve mban datën 06.07.2026.
5. Më 05.08.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Dhënien e Kontratës
6. AGS Corporation Sh.P.K., më 10.08.2026 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues për Lotet 2, 4, 14 dhe 15.
7. Autoriteti Kontraktues, me Vendimin e datës 12.08.2026, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar.
8. Ankesa e tanishme parashtrohet brenda afatit ligjor kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 12.08.2026 dhe kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 05.08.2026, për Lotet 2, 4, 14 dhe 15.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. DISPOZITAT LIGJORE TË SHKELURA

- 1.1. Me veprimet dhe mosveprimet e tij, Autoriteti Kontraktues ka shkelur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kumulative Nenin 1, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 28, paragrafin 6, Nenin 56, Nenin 59, paragrafët 2 dhe 4, si dhe Nenin 60 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Njëkohësisht, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 4.3, pikat c) dhe e), Nenin 17.12, Nenin 19.1, Nenin 19.11, Nenin 24.7, Nenin 38.2 deri 38.5 dhe Nenin 40.1, 40.2, 40.4, 40.6, 40.7 dhe 40.8 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 002/2024. Ndërkaq, veprimet dhe mosveprimet e Autoritetit Kontraktues janë gjithashtu në kundërshtim me Nenet 4, 6, 7, 8 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- 1.2. Në kuptim të Nenit 1 të LPP-së, qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik është që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke kërkuar që vendimet e autoriteteve kontraktuese të mbështeten në baza të qarta ligjore dhe faktike. Ky qëllim nuk ka karakter deklarativ, por paraqet standard detyrues për çdo fazë të aktivitetit të prokurimit, përfshirë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.
- 1.3. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për kontratë një operator ekonomik, dokumentacioni teknik i të cilit nuk e dëshmon në mënyrë të plotë përmbushjen e specifikimeve të detyrueshme për Lotet 2, 4, 14 dhe 15. Edhe pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim dhe identifikimit të mospërputhjeve konkrete, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar të korrigjojë procesin e vlerësimit dhe ka tentuar t'i rehabilitojë mangësitë e ofertës përmes shpjegimeve të mëvonshme, përvojës së njësisë kërkuuese, kërtimeve në internet dhe supozimeve teknike që nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga OE brenda afatit për ofertim.
- 1.4. Neni 7, paragrafi 1 i LPP-së përcakton shprehimisht se “[a]utoriteti kontraktues do t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Ky standard e obligon Autoritetin Kontraktues që ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë të zbatojë të njëjtat kritere, të njëjtën metodë vlerësimi si dhe të kërkojë që përmbushja e specifikimeve teknike të dëshmohet në të njëjtën mënyrë dhe përmes dokumenteve të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

- 1.5. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka zbatuar dy standarde të ndryshme vlerësimi. Pasi që nga një operator ekonomik ka kërkuar që përmbushja e specifikimeve teknike të rezultojë nga katalogu i identifikueshëm i prodhuesit dhe nga specifikimet e nënvizuara në të, ndërsa OE-së së rekomanduar për kontratë i ka pranuar një paraqitje teknike që nuk e identifikon qartë prodhuesin dhe ka tentuar të ia plotësojë këtë mangësi përmes kërkimeve të veta në Google. Pra, nga një operator ka kërkuar që provat të përmbahen në ofertën e tij, ndërsa për operatorin tjetër ka kërkuar vetë, jashtë ofertës dhe pas përfundimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, të dhënat që mungonin në dokumentacionin e dorëzuar. Theksojmë se një mënyrë e tillë e vlerësimit krijon standard të dyfishtë dhe e cenon drejtpërdrejt barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë.
- 1.6. Neni 28 i LPP-së kërkon që të gjitha specifikimet teknike të detyrueshme të përcaktohen në Dosjen e Tenderit. Ndërsa kur një operator ekonomik pretendon se produkti i tij i përmbush kërkesat në mënyrë ekuivalente, barra për ta dëshmuar ekuivalencën i takon operatorit ekonomik. Ekuivalenca nuk mund të prezumohet nga komisioni i vlerësimit dhe as të plotësohet pas përfundimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. Përkundrazi, ajo duhet të rezultojë drejtpërsëdrejti nga dosjet teknike, katalogët, raportet e testimit ose provat e tjera të paraqitura në kuadër të tenderit.
- 1.7. Në të njëjtën linjë, Neni 56, paragrafi 1 i LPP-së përcakton një rend të qartë të vlerësimit. Fillimisht vlerësohet përputhshmëria e tenderit me kërkesat e kualifikimit dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe vetëm pas konstatimit se tenderi është i përgjegjshëm bëhet vlerësimi sipas kriterit për dhënien e kontratës. Prandaj, fakti që oferta e OE-së së rekomanduar për kontratë pretendohet të jetë më e lirë me një diferencë mbi EUR 145,000.00, siç theksohet në Vendimin e Autoritetit Kontraktues, nuk ka asnjë rëndësi juridike përderisa paraprakisht nuk është vërtetuar se oferta është teknikisht e përgjegjshme.
- 1.8. Neni 59, paragrafi 4 i LPP-së përcakton se “[a]utoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Ndonëse në parim devijimet mund të tolerohen vetëm nëse janë të vogla dhe nuk shkaktojnë ndryshim material nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e përcaktuara. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gabime gjuhësore, paqartësi formale apo devijime të parëndësishme. Përkundrazi, mangësitë e konstatuara në këtë procedurë kanë të bëjnë me karakteristikat funksionale të pajisjeve mjekësore, bioabsorbueshmërinë e produktit, formën dhe natyrën e majës distale, konfigurimin dhe gjatësinë e komponentëve, kompatibilitetin me pajisjet e tjera dhe mungesën e katalogut të verifikueshëm të prodhuesit. Pra me elemente thelbësore të tyre, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në përshtatshmërinë e tyre me kërkesat e Dosjes së Tenderit (“DT”) dhe në shëndetin e pacientëve.

- 1.9. Për më tepër, Neni 59, paragrafi 2 i LPP-së e ndalon kërkimin ose pranimin e ndryshimeve materiale të tenderit pas skadimit të afatit për ofertim. Rrjedhimisht, nëse një karakteristikë e detyrueshme nuk është dëshmuar në katalogun e dorëzuar, ajo nuk mund të plotësohet më vonë përmes dokumenteve të reja, deklarimeve shtesë, informatave të gjetura në internet ose njohurive apo përvojave personale të anëtarëve të komisionit.
- 1.10. Ndërkaq, Neni 60 i LPP-së përcakton se kontrata publike i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Formulimi i ligjit në këtë rast është tejte i qartë dhe sjellë vetëm një përfundim: se çmimi më i ulët nuk është kriter i pavarur nga përgjegjshmëria e tenderit. E kundërta, vetëm pasi të konstatohet se oferta i plotëson të gjitha kërkesat administrative dhe teknike, atëherë çmimi mund të përdoret për renditjen e saj krahas ofertave tjera të përgjegjshme dhe mbi bazën e tij të vendoset për dhënien e kontratës. Kurse Autoriteti Kontraktues, duke e përdorur dallimin në çmim si argument për refuzimin e mospërputhjeve teknike, ka përmbysur rendin ligjor të vlerësimit.
- 1.11. Dosja e Tenderit e përforcon edhe më tej këtë standard. Pika 3.1 përcakton se furnizimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të Aneksit 1 dhe se përputhshmëria duhet të demonstron me provat e dokumentuara të përcaktuara në Fletën e të Dhënave të Tenderit ("FDT"). Pika 3.2 përcakton shprehimisht se "**[c]ilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikojë tenderin**".
- 1.12. Sipas pikave 21.1 dhe 21.2 të Dosjes së Tenderit, tenderuesi duhet të dorëzojë dokumentet që dëshmojnë se mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike dhe këto dokumente duhet të përmbajnë përshkrimin e detajuar të karakteristikave thelbësore teknike dhe performuese të secilit artikull të ofruar. Për më tepër, Kërkesa 4 dhe Evidenca 4 e FDT-së kanë përcaktuar shprehimisht se "**[o]fertuesi duhet që ta japë një deklaratë për specifika teknike si dhe duhet të bashkëngjitet katalogu i prodhuesit për secilin artikull të ofruar, ku duhet të nënvizohen specifikat teknike të produktit**".
- 1.13. Autoriteti Kontraktues, në Vendimin e datës 12 gusht 2026, ka deklaruar se produktet janë vlerësuar në bazë të kërkesave teknike dhe jo në bazë të prodhuesit. Mirëpo, me këtë arsyetim Autoriteti Kontraktues i ka ngatërruar kriteret e vlerësimit me mënyrën e dëshmimit të përmbushjes së tyre. Kjo pasi që Parashtruesi i Ankesës nuk ka pretenduar asnjëherë se produktet duhet të vlerësohen sipas reputacionit, origjinës apo identitetit të prodhuesit. Përkundrazi, pretendimi i tij është se vetë Dosja e Tenderit ka kërkuar që përmbushja e specifikimeve teknike të dëshmohet përmes katalogut të prodhuesit. Prandaj, produkti sigurisht që vlerësohet sipas kërkesave teknike të dhëna, por dokumenti përmes të cilit dëshmohet përmbushja e tyre duhet të jetë katalog i identifikueshëm i prodhuesit. Kurse një paraqitje teknike që nuk e identifikon prodhuesin nuk mund të pranohet si katalog i tij vetëm sepse përmban të dhëna

teknike. Rrjedhimisht, nuk mjafton që dokumenti i dorëzuar të përmbajë të dhëna teknike; nga vetë dokumenti duhet të rezultojë qartë se ai është katalog i prodhuesit, ashtu sic është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

- 1.14. Neni 17.12 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se Autoriteti Kontraktues duhet t'i deklarojë në Dosjen e Tenderit të gjitha informatat relevante që operatorëve ekonomikë u nevojiten për përgatitjen e tenderëve dhe se Dosja e Tenderit paraqet materialin themelor mbi bazën e të cilit përgatiten ofertat. Ndërkaq, Nenet 19.1 dhe 19.11 të së njëjtës Rregullore përcaktojnë se specifikimet teknike janë kërkesa të detyrueshme, të cilat duhet të përmbushen nga çdo tender që të konsiderohet i përgjegjshëm. Prandaj, as njësia kërkuuese dhe as komisioni vlerësues nuk kanë kompetencë që, pas hapjes së tenderëve, t'i trajtojnë si orientuese kërkesat që janë publikuar si pjesë e dokumentacionit të tenderit.
- 1.15. Neni 24.7 i Rregullores përcakton procedurën për ndryshimin ose përmirësimin e Dosjes së Tenderit para përfundimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues i është përgjigjur me "Po" kërkesave për ndryshimin e parametrave të Loteve 2, 4 dhe 15 dhe më pas ka publikuar Formularin B54. Nga momenti i publikimit, këto ndryshime janë bërë pjesë e bazës përfundimtare mbi të cilën operatorët ekonomikë kanë pasur të drejtë t'i përgatisin ofertat e tyre. Neni 40.2 i Rregullores ia ndalon shprehimisht Autoritetit Kontraktues që gjatë vlerësimit të ndryshojë, modifikojë ose largojë kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara paraprakisht. Për pasojë, Autoriteti Kontraktues nuk mund t'i publikojë ndryshimet para ofertimit dhe pastaj, pas hapjes së tenderëve, të deklarojë se të njëjtat nuk përbëjnë kushte përfundimtare të vlerësimit.
- 1.16. Neni 38.2 dhe Nenet 40.4 e 40.8 të Rregullores e ndalojnë çdo sqarim që rezulton në ndryshimin e një kushti ose aspekti material të tenderit. Këto dispozita nuk lejojnë që mungesa e një karakteristike teknike, e katalogut të prodhuesit ose e lidhjes së verifikueshme ndërmjet dokumentit dhe produktit të ofertuar të plotësohet pas përfundimit të afatit. Aq më pak lejohej që Autoriteti Kontraktues ta bëjë vetë këtë plotësim përmes kërkimeve në internet, njohurive personale të anëtarëve të komisionit ose interpretimeve teknike që nuk rezultojnë nga oferta e dorëzuar.
- 1.17. Krahës shkeljeve materiale të LPP-së të elaboruara më sipër, kjo procedurë është shoqëruar edhe me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("**LPPA**" ose "**Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative**"). Në veçanti, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në Nenin 4, parimin e barazisë nga Neni 6, parimin e objektivitetit dhe paanësisë nga Neni 7, si dhe parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme nga Neni 8 i LPPA-së.
- 1.18. Parimi i ligjshmërisë është cenuar për shkak se Autoriteti Kontraktues, në vend që vlerësimin ta kufizojë në kërkesat e përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit

dhe në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, ka përdorur kritere dhe konsiderata që nuk rezultojnë nga dokumentet e procedurës, duke u mbështetur edhe në interpretime, analogji dhe informata që pretendohet se mund të gjenden jashtë ofertës.

- 1.19. Parimi i barazisë është cenuar për shkak se pranimi i një oferte mbi bazën e informatave, sqarimeve ose supozimeve që nuk rezultojnë qartë nga dokumentacioni i dorëzuar krijon një standard të ndryshëm vlerësimi nga ai që duhet të zbatohet njësoj ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Operatorët ekonomikë që kanë përgatitur ofertat e tyre duke respektuar në mënyrë strikte kërkesat e Dosjes së Tenderit nuk mund të vendosen në pozitë më të pafavorshme kundrejt një operatori tjetër, oferta e të cilit plotësohet ose interpretohet në mënyrë favorizuese pas afatit për dorëzimin e tenderëve.
- 1.20. Parimi i objektivitetit dhe paanësisë është cenuar vecanërisht përmes mbështetjes së Autoritetit Kontraktues në përvojën personale të njësisë kërkuese dhe në vlerësime të përgjithshme që nuk janë të lidhura me prova konkrete të administruara gjatë procedurës. Vlerësimi i ofertave duhet të mbështetet në dokumentacion të verifikueshëm dhe në kriteret e përcaktuara paraprakisht, e jo në njohuri personale, përvoja të mëhershme apo supozime subjektive të anëtarëve të njësisë kërkuese ose të komisionit vlerësues.
- 1.21. Po ashtu është cenuar edhe parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, pasi operatorët ekonomikë kishin të drejtë të prisnin që ofertat e tyre të vlerësoheshin ekskluzivisht sipas kërkesave, specifikimeve dhe kritereve të publikuara paraprakisht nga vetë Autoriteti Kontraktues. Ndryshimi praktik i mënyrës së interpretimit ose zbatimit të këtyre kërkesave vetëm pas hapjes së ofertave cenon sigurinë juridike dhe besimin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë se rregullat e procedurës do të mbeten të njëjta dhe do të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme deri në përfundimin e saj.
- 1.22. Për më tepër, Neni 48 i LPPA-së kërkon që arsyetimi i aktit administrativ të përmbajë paraqitjen e gjendjes faktike, shkaqet vendimtare që kanë udhëhequr vlerësimin e provave, bazën ligjore të vendimit, si dhe arsyet për të cilat nuk janë pranuar pretendimet e palës. Vendimi i datës 12 gusht 2026 nuk e përmbush as standardin minimal të arsyetimit të kërkuar nga kjo dispozitë. Në vend që të identifikojë dokumentet konkrete të ofertës dhe specifikimet teknike mbi të cilat mbështeten konstatimet e tij, Autoriteti Kontraktues është mbështetur në pohime të përgjithshme, në përvojën personale të njësisë kërkuese, në analogji dhe në të dhëna për të cilat pretendohet se mund të gjenden jashtë dokumentacionit të ofertës.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. GJENDJA FAKTIKE

- 1.1. Më 4 qershor 2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material për stroke nga LE”. Duke qenë se objekti i këtij aktiviteti përfshin pajisje dhe materiale që përdoren gjatë procedurave neurointervente dhe trajtimit të pacientëve me “stroke,” në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit janë përcaktuar karakteristika të hollësishme teknike dhe funksionale për secilin produkt.
- 1.2. Karakteristikat e tilla nuk janë vendosur aty vetëm si përshkrime orientuese. Vetë Dosja e Tenderit i ka cilësuar ato si specifikime teknike të detyrueshme dhe ka përcaktuar se çdo mospërputhje me to e diskualifikon tenderin. Prandaj, për ta bërë të mundur verifikimin e përputhshmërisë në mënyrë strikte, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që për secilin artikull të dorëzohet katalogu i prodhuesit dhe që në katalog të nënvizohen specifikimet teknike të produktit të ofertuar.
- 1.3. Gjatë fazës së sqarimeve, operatorët ekonomikë kanë paraqitur pyetje dhe kërkesa për ndryshimin ose zgjerimin e disa specifikimeve. Në Pyetjen nr. 4, OE i cili më pas është rekomanduar për kontratë ka kërkuar që për Lotin 2 të lejohet ofertimi me një produkt ekuivalent që plotëson diametrin dhe gjatësinë e kërkuar dhe që është kompatibil me mikrokateret 0.021” dhe 0.027”, pa formulimin kufizues për 2–3 dritare hapëse. Për Lotin 4 është kërkuar lejimi i mikrokaterëve me diametër 2.1–2.8F dhe diametër të brendshëm 0.021”–0.027”, ndërsa për Lotin 15 është kërkuar lejimi i kateterit aspirues 5F me diametër të brendshëm 0.50–0.58”.
- 1.4. Autoriteti Kontraktues është përgjigjur se, për pyetjet lidhur me Lotet 2, 4 dhe 15, përgjigjja është “Po”. Këto sqarime janë publikuar para afatit përfundimtar për dorëzimin e tenderëve dhe janë pasuar nga publikimi i korrigjimit B54. Sipas pikës 17.2 të Dosjes së Tenderit, çdo shtojcë e lëshuar bëhet pjesë e Dosjes së Tenderit. Prandaj, kushtet e ndryshuara dhe të lejuara përmes sqarimeve janë bërë pjesë e kushteve përfundimtare mbi bazën e të cilave është dashur të përgatiten dhe të vlerësohen të gjitha ofertat.
- 1.5. Paraprakisht, më 26 qershor 2026, Parashtruesi i Ankesës kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim lidhur me kushtet e Dosjes së Tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktues e kishte refuzuar atë kërkesë me vendimin e datës 2 korrik 2026. Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues më 5 gusht 2026 dhe shqyrtimit të dokumentacionit teknik të OE-së së rekomanduar, Parashtruesi i Ankesës ka konstatuar mospërputhje konkrete për Lotet 2, 4, 14 dhe 15. Për këtë arsye, më 10 gusht 2026 është paraqitur kërkesa për rishqyrtim, në të cilën janë

identifikuar produktet, modelet, karakteristikat e munguara dhe dokumentet që nuk mundësojnë verifikimin e prodhuesit.

- 1.6. Më 12 gusht 2026, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar. Ky i fundit, në vend se t'i krahasonte karakteristikat e kërkuara me të dhënat e katalogut të dorëzuar nga OE, i njëjti ka tentuar t'i plotësojë boshllëqet e ofertës me interpretimet e veta. Kështu, për disa produkte është mbështetur në përvojën e mëparshme të klinikës, për disa në supozimin se një diametër më i vogël domosdoshmërisht dëshmon kompatibilitet me një diametër më të madh, ndërsa për identifikimin e prodhuesve ka deklaruar se mjafton një kërkim i thjeshtë në Google. Theksojmë se një mënyrë e tillë vlerësimi është në kundërshtim të plotë me përcaktimet e legjislacionit në fuqi, sic do të elaborohet në vijim.

2. PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS LOTEVE

Loti 2 – Pozita 1: Rrjeta në formë filtri në pjesën distale

- 2.1. Për pozitën 1 të Lotit 2, e cila paraqitet si artikulli nr. 2 në listën e përgjithshme të Aneksit 1, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar largues të trombit që, ndër të tjera, “posedon minimum 2 marker dhe rrjetën në formë të filtrit që do të ndalojë largimin-shpërndarjen e mikrotrombeve të cilat krijohen gjatë procedurës së trombektomisë”.
- 2.2. Me këtë specifikim, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar jo vetëm praninë e një strukture në pjesën distale, por një rrjetë në formë filtri me funksion të përcaktuar qartë. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me sigurinë dhe funksionin e pajisjes, pasi rrjeta shërben për kapjen e fragmenteve të trombit dhe zvogëlimin e rrezikut të embolizimit distal gjatë tërheqjes së tij. Në mungesë të mekanizmit të kërkuar të filtrimit, fragmente të vogla të trombit mund të shpëputen dhe të migrojnë në qarkullimin cerebral, duke krijuar rrezik për okluzione të tjera. Prandaj, kjo karakteristikë nuk mund të trajtohet vetëm si element formal i katalogut. Pikërisht për shkak të rëndësisë së saj klinike, përmbushja e kësaj kërkesë është dashur të dëshmohet qartë në dokumentacionin teknik të ofertës dhe nuk mund të prezumohet nga Autoriteti Kontraktues.
- 2.3. Në katalogun e OE-së së rekomanduar është markuar dhe ofertuar vetëm modeli TIGERTRIEVER TRPP3155, me diametër 1.5–6.0 mm, gjatësi 32 mm dhe kompatibilitet të deklaruar me mikrokater 0.021”. Në broshurë përdoret termi “Distal embolic net”, mirëpo, Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar vetëm ekzistimin e një rrjete apo të një strukture mbrojtëse në pjesën distale. Përkundrazi, kërkesa ka qenë e përcaktuar shprehimisht që produkti të përmbajë dhe “rrjetën në formë të filtrit” duke e treguar edhe funksionin konkret që kërkohet të arrihet me të, përkatësisht ndalimn e largimit dhe shpërndarjes së mikrotrombeve. Në faqen e markuar të katalogut të OE-së së rekomanduar askund nuk figuron termi “microfiltration” dhe as ndonjë përshkrim tjetër i prodhuesit që e lidh atë me

funkcionin e ndalimit të mikrotrombeve. Nëse merret për krahasim materiali/prodakti i ofertuar nga Parashtruesit të Ankesës, vërehet qartë se funksioni përkatës deklarohet shprehimisht në broshurë përmes formulimeve “Micro filtration technology” dhe “designed to maximize clot retention”. Lidhur me këtë, theksojmë se ky krahasim bëhet vetëm për të qartësuar se broshura e paraqitur për produktin e OE-së së rekomanduar nuk e deklaron dhe nuk është në përputhje me funksionin që Dosja e Tenderit e ka kërkuar. Prandaj, vetëm emërtimi “Distal embolic net” nuk përbën dëshmi se është përmbushur kërkesa për rrjetën në formë filtri me funksionin e përcaktuar në DT dhe për rrjedhojë rezulton se ky produkt nuk i plotëson kërkesat e kësaj të fundit.


Deshmi: Dok.nr.12 i bashkangjitur.

- 2.4. Në Vendimin e datës 12 gusht 2026, Autoriteti Kontraktues deklaron se pretendimi për mungesën e filtrit distal nuk qëndron, pasi në DT nuk është kërkuar që stent-retriever-i të jetë filtër. Sipas Autoritetit Kontraktues, po të kërkohej filtër, atëherë do të duhej të përcaktohej edhe madhësia e poreve, sikurse është bërë për një produkt tjetër në Lotin 16.
- 2.5. Lidhur me këtë theksojmë se arsyetimi i Autoritetit Kontraktues mbështetet në një interpretim të gabuar të pretendimit të Parashtruesit të Ankesës. Ky i fundit nuk ka pretenduar se i gjithë stent-retriever-i është dashur të klasifikohet si filtër, por se Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht që produkti, në pjesën distale, të posedojë “rrjetën në formë të filtrit”, me funksionin e ndalimit të largimit dhe shpërndarjes së mikrotrombeve. Ndërsa fakti se Dosja e Tenderit nuk e ka përcaktuar madhësinë e poreve nuk e eliminon këtë kërkesë, sepse ekzistimi dhe funksioni i rrjetës në formë filtri nuk janë kushtëzuar me ndonjë madhësi të caktuar të poreve. Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përdorë mungesën e këtij parametri për ta konsideruar të panevojshme një karakteristikë të kërkuar shprehimisht në specifikimin teknik. Një interpretim i tillë, i dhënë vetëm pas hapjes së tenderëve, e ndryshon përmbajtjen e specifikimit teknik mbi bazën e të cilit është dashur të përgatiten dhe të vlerësohen ofertat.
- 2.6. Në të njëjtën linjë, arsyetimi i Autoritetit Kontraktues përmban edhe një pasaktësi materiale në identifikimin e dokumentacionit të tenderit. Kjo pasi që pajisja “Embolic Protection Device”, për të cilën janë përcaktuar poret prej 100 mikronësh, nuk është produkt i Lotit 16, siç thuhet në Vendim. Përkundrazi, ajo paraqitet si artikulli nr. 16 në kuadër të Lotit 13. Ndërkaq, Loti 16 përmban artikujt nr. 24 dhe 25, përkatësisht setin për PTBD dhe setin për nefrostomë. Kjo pasaktësi tregon se krahasimi i tillë është bërë pa identifikimin e saktë të lotit dhe të specifikimit të cilit i referohet. Mirëpo edhe nëse referenca të korrigjohej dhe të lidhej me Lotin 13, ajo përsëri do të ishte e parëndësishme për pretendimin e Autoritetit Kontraktues, sepse secili lot përmban specifikimet e veta përkatëse. Kurse përcaktimi i madhësisë së poreve për një pajisje tjetër nuk e eliminon kërkesën e shprehur në Lotin 2 dhe nuk i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën që t’i atribuojë produktit të ofertuar nga OE e rekomanduar një funksion filtrues të cilin katalogu i markuar nuk e deklaron.

Në kërkesën për sqarime, vetë OE i rekomanduar ka kërkuar që të lejohet ofertimi i një stent-retriever-i me variacione të ndryshme të diametrit dhe gjatësisë, kompatibil me mikrokateret 0.021" dhe 0.027", pa kërkesën për 2–3 dritare hapëse. Autoriteti Kontraktues e ka pranuar këtë kërkesë. Megjithatë, nga dokumentacioni i markuar dhe i bashkëngjitur kësaj Ankese rezulton se OE ka ofertuar vetëm modelin TIGERTRIEVER TRPP3155. RËjedhimisht, variacionet mbi të cilat OE e kishte mbështetur kërkesën e tij për ndryshimin e specifikut nuk janë përfshirë në ofertën përfundimtare. Për më tepër, pranimi i kërkesës së OE-së kishte të bënte me variacionet e diametrit dhe gjatësisë, kompatibilitetin me mikrokateret përkatës dhe largimin e kërkesës për 2–3 dritare hapëse. Ky ndryshim nuk e ka hequr kërkesën e veçantë që produkti të posedojë rrjetën në formë filtri në pjesën distale, me funksionin e ndalimit të largimit dhe shpërndarjes së mikrotrombeve. Prandaj, OE i rekomanduar ka pasur detyrimin që përmbushjen e kësaj kërkesë ta dëshmojë përmes dokumentacionit teknik të ofertës.

Deshmi: Dok.nr.12 i bashkëngjitur.

- 2.7. Ndërkaq, vetëm përdorimi i termit “Distal embolic net” nuk dëshmon automatikisht përmbushjen e funksionit të kërkuar. Autoriteti Kontraktues është dashur të identifikojë në katalogun e prodhuesit vendin ku vërtetohet se struktura e produktit ndalon largimin dhe shpërndarjen e mikrotrombeve. Kurse Vendimi nuk e përmban një identifikim të tillë dhe, për pasojë, konstatimi se produkti e plotëson kërkesën është nxjerrë pa mbështetje në dokumentacionin teknik të dorëzuar. Për më tepër, nga fotografia e produktit të ofertuar nga OE i rekomanduar, e paraqitur edhe në Kërkesën për Rishqyrtim, nuk evidentohet rrjeta në formë filtri në majën ose pjesën distale të stentit, ndërsa në fotografinë krahasuese të produktit të Parashtruesit të Ankesës kjo rrjetë është qartësisht e dukshme. Për këtë arsye, fotografitë dhe faqet përkatëse të katalogëve duhet të administrohen dhe të krahasohen me specifikimin teknik të Dosjes së Tenderit.



- 2.8. Në lidhje me kompatibilitetin, katalogu i modelit të markuar paraqet vetëm “Minimum Microcatheter Compatibility ID 0.021”. Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se një pajisje që kalon në mikrokaterin 0.021” logjikisht kalon edhe në

mikrokateterin 0.027". Edhe ky përfundim si i tillë mbështetet vetëm në interpretimin e njësisë kërkuese dhe jo në deklarin e prodhuesit. Nëse DT dhe sqarimi kanë kërkuar kompatibilitetin me konfigurimet përkatëse, atëherë ky kompatibilitet është dashur të rezultojë nga katalogu dhe të jetë i nënvizuar sipas Evidencës 4. Kjo mangësi ka edhe rëndësi funksionale, sepse kufizon gamën e pajisjeve që reparti mund të përdorë dhe mundësinë e përzgjedhjes së stent-retriever-it sipas anatomisë dhe nevojave të pacientit. Rrjedhimisht, pranimi i produktit pa u dëshmuar në dokumentacionin e markuar funksioni i rrjetës në formë filtri dhe kompatibiliteti i kërkuar përbën shkelje të Nenit 59, paragrafi 4 të LPP-së, Nenit 19.11 dhe Nenit 40.2, 40.6, pika b), dhe 40.7 të Rregullores. Këto mangësi kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin e vlerësimit, sepse një tender që nuk e dëshmon përmbushjen e specifikimeve të detyrueshme është trajtuar si i përgjegjshëm dhe është rekomanduar për kontratë.

Loti 2 – Pozita 4: Mbyllësi femoral bioabsorbues

- 2.9. Për pozitën 4 të Lotit 2, e paraqitur si artikulli nr. 5 në Aneksin 1, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar "Vascular Closure Device – Mbyllës femoral bioabsorbues menjëherë pas procedurës angiografike, me madhësi 5F, 6F, 7F dhe 8F".
- 2.10. Në dokumentacionin teknik të markuar për produktin AngioTEN nuk figuron, nuk deklarohet dhe nuk është nënvizuar në asnjë pjesë se produkti është bioabsorbues. Mangësia e tillë nuk mund të trajtohet thjeshtë si formale por duhet të cilësohet si mungesë e drejtpërdrejtë e dëshmisë për përmbushjen e një karakteristike të detyrueshme, të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Në këtë të fundit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar qartë mbyllës femoral **bioabsorbues** dhe, për rrjedhojë, kjo karakteristikë do duhej të rezultonte në mënyrë të qartë, të verifikueshme dhe të dokumentuar nga oferta e OE të rekomanduar. Në mungesë të një deklarimi të tillë, përmbushja e kërkesës nuk mund të prezumohet, të nxirret me interpretim apo të plotësohet nga Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit. Prandaj, vlerësimi i produktit AngioTEN si në përputhje me këtë kërkesë, pa asnjë provë që konfirmon bioabsorbueshmërinë e tij, është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit dhe e bën të pambështetur konstatimin për përgjegjshmërinë e ofertës.

Deshmi: Dok.nr.13 i bashkangjitur.

- 2.11. Në vend që ta identifikojë pjesën e katalogut ku dëshmohet bioabsorbueshmëria, Autoriteti Kontraktues ka përshkruar mënyrën e funksionimit të produktit AngioTEN dhe e ka krahasuar atë me produkte të tjera. Theksojmë se ky arsyetim nuk i përgjigjet kërkesës së Dosjes së Tenderit. Kjo pasi që fakti se produkti e realizon mbylljen vaskulare përmes një mekanizmi tjetër nuk e bën atë bioabsorbues dhe nuk e autorizon Autoritetin Kontraktues që pas hapjes së

tenderëve ta zëvendësojë karakteristikën e kërkuar me një vlerësim se mekanizmi tjetër është më i përshtatshëm ose më i sigurt.

- 2.12. Nëse Autoriteti Kontraktues ka synuar të lejojë edhe produkte që nuk janë bioabsorbuese, këtë është dashur ta përcaktojë para përfundimit të afatit për ofertim. Nëse OE i rekomanduar ka pretenduar ekuivalencë, atë është dashur ta dëshmojë në ofertë në përputhje me Nenin 28, paragrafin 6 të LPP-së. Në rastin konkret nuk ka ndodhur as njëra dhe as tjetra. Prandaj, për këtë arsye, panimi i produktit pa u dëshmuar karakteristika “bioabsorbuese” përbën shkelje të Nenit 59, paragrafi 4 të LPP-së dhe Neneve 19.11, 40.2 dhe 40.6, pika b), të Rregullores. Për pasojë, tenderi i OE-së së rekomanduar nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm për këtë pozicion.

Loti 4 – Mikrokateteri intrakranial

- 2.13. Për Lotin 4, përmes përgjigjes së dhënë në Pyetjen nr. 4, Autoriteti Kontraktues ka lejuar ofertimin e mikrokateterëve me diametër 2.1–2.8F dhe diametër të brendshëm 0.021”–0.027”. Ky ndryshim është kërkuar nga vetë OE i cili më pas është rekomanduar për kontratë dhe është pranuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 2.14. Në kërkesën për rishqyrtim është theksuar se vetëm dy modelet NORO-CATH 21, me diametër të brendshëm 0.021”, paraqiten në përputhje me konfigurimin e lejuar 2.1–2.8F, ndërsa modelet NORO-CATH 27, me diametër të brendshëm 0.027”, paraqiten me konfigurimet 2.6–2.8F dhe 2.6–3.1F. Këto konfigurime nuk e dëshmojnë gamën e plotë 2.1–2.8F, ndërsa konfigurimi 2.6–3.1F e tejkalon kufirin maksimal të lejuar prej 2.8F. Kjo është vecanërisht problematike për faktin se vetë OE i rekomanduar e ka kërkuar ndryshimin e specifikimit, Autoriteti Kontraktues e ka pranuar kërkesën e tij, ndërsa dokumentacioni teknik i ofertës nuk dëshmon përputhshmëri të plotë as me parametrat e ndryshuar.

Deshmi: Dok.nr.14 i bashkangjitur.

- 2.15. Ndonëse në Vendimin e datës 12 gusht 2026, Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se janë ofertuar NORO-CATH 21, modelet MC21F27F150 dhe MC24F27F150, me diametra 2.1–2.7F dhe 2.4–2.7F, si dhe NORO-CATH 27, modeli MC26F28F150, me diametër 2.6–2.8F. Megjithatë, Vendimi nuk e identifikon faqen dhe markimin e ofertës origjinale nga të cilat rezulton se vetëm këto tri modele janë ofertuar dhe se konfigurimi 2.6–3.1F, i paraqitur në dokumentacionin teknik, nuk është pjesë e ofertës. Vetëm citimi i kodeve të produkteve në Vendim nuk e zëvendëson identifikimin e modeleve që janë markuar dhe ofertuar para përfundimit të afatit. Për rrjedhojë, pretendimi se oferta nuk dëshmon përputhshmëri të plotë me specifikimet përfundimtare të Lotit 4 ka mbetur pa përgjigje të mbështetur në dokumentacionin konkret të ofertës.

Deshmi: Dok.nr.14 i bashkangjitur.

- 2.16. Përveç mospërputhjeve teknike, dokumenti i paraqitur si broshurë për NORO-CATH nuk përmban identifikim të qartë dhe të verifikueshëm të prodhuesit. Në të nuk figurojnë qartë emri dhe logoja e prodhuesit, adresa, faqja elektronike, emaili ose numri i telefonit, numri i dokumentit ose i broshurës, versioni apo revizioni dhe data e dokumentit. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se prodhuesi mund të identifikohet duke e kërkuar emrin e produktit në “Google” dhe se në ofertë ekzistojnë certifikata, autorizime dhe dokumente të tjera.
- 2.17. Sa i përket arsyetimit të Autoritetit Kontraktues se prodhuesi mund të identifikohet përmes një “kërkimi në Google”, theksojmë se një arsyetim i tillë është juridikisht i papranueshëm dhe në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit. Vetë fakti që Autoriteti Kontraktues ka pasur nevojë të kërkojë në internet për të identifikuar subjektin që pretendohet se ka lëshuar dokumentacionin teknik, dëshmon se identiteti i prodhuesit nuk rezulton qartë dhe në mënyrë të verifikueshme nga dokumentacioni i dorëzuar me ofertë.
- 2.18. Në lidhje me këtë, Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar si dëshmi një faqe interneti në të cilën komisioni vlerësues mund të qaset, kërkojë dhe lidhë më pas me një prodhues të caktuar. Përkundrazi, DT ka kërkuar shprehimisht katalogun e prodhuesit për secilin artikull të ofertuar, me specifikimet teknike përkatëse të nënvizuara. Për rrjedhojë, një “kërkim në Google” nuk përbën dokument të ofertës, nuk mund të cilësohet si “dëshmi” e dorëzuar brenda afatit për paraqitjen e tenderit dhe nuk mund të përdoret për të plotësuar retroaktivisht mungesën e identifikimit të prodhuesit në dokumentacionin teknik të dorëzuar.
- 2.19. Në të njëjtën mënyrë, autorizimi i prodhuesit dhe certifikatat përkatëse janë kërkuar si dokumente të veçanta dhe kumulative dhe nuk mund të përdoren si zëvendësim për katalogun e kërkuar. Secili prej këtyre dokumenteve ka funksion të veçantë dëshmuar dhe përmbushja e një kërkesë nuk e përjashton detyrimin për përmbushjen e tjetrës.
- 2.20. Duke kërkuar jashtë ofertës informata që OE e rekomanduar ka qenë i detyruar t’i paraqesë vetë brenda dokumentacionit të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kaluar nga verifikimi i ofertës së dorëzuar në plotësimin material të saj. Në këtë mënyrë, ai i ka mundësuar operatorit ekonomik të rekomanduar të përfitojë nga të dhëna që nuk kanë qenë pjesë e ofertës së tij brenda afatit, duke zbatuar ndaj tij një standard më të favorshëm nga ai që duhej të zbatohet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë.
- 2.21. Për më tepër, nëse Autoriteti Kontraktues pretendon se dokumentet e tjera të ofertës e lidhin faqen teknike të NORO-CATH me një prodhues të caktuar, atëherë është dashur ta identifikojë atë lidhje në Vendim, duke treguar prodhuesin, modelin konkret, dokumentin përkatës dhe mënyrën se si është

vërtetuar autenticiteti i katalogut. Ndërsa Vendimi nuk përmban një analizë të tillë. Prandaj, në lidhje me Lotin 4, është e domosdoshme që OSHP-ja ta administrojë ofertën origjinale elektronike dhe të verifikojë kodet e markuara të produkteve, deklaratën teknike dhe dokumentin e paraqitur si katalog i prodhuesit. Pa një verifikim të tillë, konstatimi i Autoritetit Kontraktues se oferta është e përgjegjshme mbetet i pambështetur në prova dhe dokumentacion teknik dhe si i tillë është i kundërligjshëm.

Loti 14 – Pozitat 1 dhe 2: Maja distale atraumatike dhe e lakuar në formë J

- 2.22. Për pozitat 1 dhe 2 të Lotit 14, përkatësisht artikujt nr. 17 dhe 18 të Aneksit 1, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që larguesi i trombit, në pjesën distale, të posedojë majë atraumatike të lakuar në formë të germës “J,” e cila nuk shkakton dëmtim të enës së gjakut gjatë procedurës së trombektomisë.
- 2.23. Nga dokumentacioni teknik i paraqitur për produktet TIGERTRIEVER nuk dëshmohet shprehimisht se maja distale është atraumatike dhe e lakuar në formë J. Është me rëndësi të theksohet se këto janë dy karakteristika të shprehura qartë si specifika teknike të domosdoshme dhe do të duhej që të njëjtat të rezultojnë qartë nga katalogu i prodhuesit.

Deshmi: Dok.nr.15 i bashkangjitur.

- 2.24. Në Vendimin e datës 12 gusht 2026, Autoriteti Kontraktues deklaroi se maja e pajisjes është më e gjatë dhe më fleksibile dhe se, për shkak të gjatësisë dhe fleksibilitetit të saj, nuk është traumatike për enën e gjakut. Autoriteti Kontraktues më tej mbështetet në përvojën e klinikës me këto pajisje dhe deklaroi se nuk ka pasur raste të dëmtimit të enëve të gjakut gjatë përdorimit të tyre.
- 2.25. Në lidhje me këtë, theksojmë se as gjatësia dhe fleksibiliteti i majës, dhe as përvoja e mëparshme e klinikës me përdorimin e produktit nuk dëshmojnë dy karakteristikat konkrete të kërkuara në Dosjen e Tenderit. Një majë më e gjatë dhe më fleksibile nuk është e njëjtë me një majë të lakuar në formë J, ndërsa fakti se gjatë përdorimit të mëparshëm nuk janë evidentuar dëmtime të enëve të gjakut nuk dëshmon se dëmtime të tilla nuk do ndodhin në të ardhmen.
- 2.26. Nga kjo është e qartë se përputhshmëria e produktit është dashur të konstatohet mbi bazën e karakteristikave të dëshmuara në ofertë. Ndërsa, pranimi i gjatësisë dhe fleksibilitetit në vend të formës J të kërkuar shprehimisht përbën zëvendësim të specifikimit teknik pas përfundimit të afatit për ofertim.
- 2.27. Kjo çështje lidhet drejtpërdrejt edhe me pretendimin e paraqitur në kërkesën për rishqyrtim se i njëjti produkt, **TIGERTRIEVER**, është përdorur për pozitën 1 të Lotit 2 dhe për pozitat 1 dhe 2 të Lotit 14, përkatësisht në dy lote dhe tri

pozicione të ndara. Ndarja në këto dy lote nuk është bërë formalisht, por për shkak se në Lotin 2 është kërkuar një model stent-retriever-i për nevoja të caktuara klinike të departamentit, ndërsa në Lotin 14 është kërkuar një lloj tjetër stent-retriever-i, i destinuar për nevoja dhe situata të tjera klinike.

Autoriteti Kontraktues e ka kundërshtuar këtë pretendim duke deklaruar se janë ofertuar dy lloje të ndryshme të stent-retriever-ëve. Megjithatë, tabela e përgjithshme e familjes TIGERTRIEVER, e paraqitur në Vendim, nuk e identifikon kodin konkret të produktit të ofertuar për secilën pozitë dhe nuk dëshmon se për artikujt nr. 17 dhe 18 janë ofertuar modele të ndryshme nga modeli i ofertuar në Lotin 2.

Përfundimisht, në dy lote dhe tri pozicione të ndara po pranohet i njëjti stent-retriever, pavarësisht se secili lot është krijuar për të mbuluar nevoja të ndryshme klinike të departamentit. Nëse i njëjti produkt konsiderohet i përshtatshëm për të gjitha këto pozicione, atëherë humbet plotësisht arsyeja pse Autoriteti Kontraktues i ka ndarë ato në dy lote dhe tri pozicione të veçanta. Ndarja në lote të ndryshme duhet të pasqyrojë dallime reale në destinimin klinik, karakteristikat teknike, mënyrën e përdorimit dhe nevojat që duhet të përmbushë secili produkt. Ajo nuk mund të trajtohet vetëm si një ndarje formale, ndërkohë që në fazën e vlerësimit pranohet i njëjti produkt për të gjitha kërkesat.

Pranimi i të njëjtit stent në të dyja lotet e zbraz nga përmbajtja vetë strukturën e Dosjes së Tenderit dhe e bën ndarjen në lote praktikisht të pakuptimtë. Nëse Lotet 2 dhe 14 do të synonin furnizimin me të njëjtin stent-retriever, nuk do të ekzistonte asnjë arsye objektive që ato të krijoheshin si lote të ndara dhe të përmbanin tri pozicione të veçanta. Përkundrazi, ekzistenca e loteve të ndara dëshmon se Autoriteti Kontraktues ka identifikuar nevoja të ndryshme dhe ka kërkuar produkte me funksione ose karakteristika të dallueshme për trajtimin e situatave të ndryshme klinike.

Prandaj, pranimi i të njëjtit TIGERTRIEVER në të dyja lotet jo vetëm që e kufizon ndjeshëm gamën e produkteve, por edhe e cenon qëllimin funksional të ndarjes në lote, duke bërë që departamenti, në vend të modeleve të ndryshme të kërkuara për nevoja të ndryshme, të furnizohet në tri pozicione me të njëjtën zgjidhje teknike. Një rezultat i tillë nuk siguron llojllojshmërinë funksionale dhe klinike të synuar përmes strukturimit të Dosjes së Tenderit dhe është në kundërshtim me vetë logjikën mbi të cilën janë krijuar Lotet 2 dhe 14.

Loti 14 – Pozita 3: Seti i kateterit intrakranial/NEURO-SHEATH

2.28. Për pozitën 3 të Lotit 14, përkatësisht artikullin nr. 19 të Aneksit 1, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një set të kateterit intrakranial në të cilin mbështjellësi me madhësi 5F, 6F, 7F dhe 8F duhet të ketë gjatësi 80 cm ose më shumë, ndërsa pjesa e brendshme e kateterit duhet të ketë gjatësi 110–120 cm ose më shumë.

2.29. Broshura e paraqitur për NEURO-SHEATH – Guiding Catheter Dilator Kit

përmban variante me gjatësi 45, 55, 65, 80, 90 dhe 110 cm. Mirëpo, nga faqja e paraqitur nuk rezulton qartë se cilat prej këtyre gjatësive i referohen mbështjellësit të jashtëm, cilat i referohen pjesës së brendshme dhe cili kod produkti përmban kombinimin e kërkuar prej së paku 80 cm për pjesën e jashtme dhe së paku 110 cm për pjesën e brendshme.

Deshmi: Dok.nr.16 i bashkangjitur.

- 2.30. Në Vendimin e datës 12 gusht 2026, Autoriteti Kontraktues deklaron se është standard i përgjithshëm për secilin prodhues që pjesa e jashtme e guiding catheter set të jetë më e shkurtër se dilatatori dhe se kjo shihet edhe nga ilustrimi në broshurë. Theksojmë se ky arsyetim asesi nuk dëshmon parametrat numerikë të kërkuar në Dosjen e Tenderit. Fakti se një pjesë paraqitet vizualisht më e shkurtër se pjesa tjetër nuk dëshmon se pjesa e jashtme ka gjatësi së paku 80 cm dhe se pjesa e brendshme ka gjatësi së paku 110 cm. Prandaj, një ilustrim relativ i dy komponentëve nuk mund ta zëvendësojë specifikimin numerik të prodhuesit.
- 2.31. Po ashtu, fakti që gjatësia 110 cm figuron në tabelën e broshurës nuk mjafton vetvetiu. Përkundrazi, duhet të dëshmohet se kjo gjatësi i referohet pikërisht pjesës së brendshme të setit dhe se është e kombinuar me mbështjellës të jashtëm me gjatësi së paku 80 cm. Ndërsa Vendimi nuk identifikon asnjë kod konkret të produktit që e përmbush këtë konfigurim.
- 2.32. Gjithashtu, faqja e paraqitur si broshurë për NEURO-SHEATH – Guiding Catheter Dilator Kit nuk përmban elementet bazë që mundësojnë identifikimin dhe verifikimin e dokumentit. Në të nuk paraqiten emri dhe identifikimi i qartë i prodhuesit, adresa, faqja elektronike, kontaktet, numri i dokumentit ose i broshurës, versioni apo revizioni dhe data e dokumentit. Edhe pse paraqiten kode produktesh si GC5F-STRKIT, GC6F, GC7F dhe GC8F, vetë faqja nuk e identifikon subjektin prodhues që qëndron pas këtyre kodeve. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues është mbështetur në arsyetimin se prodhuesi mund të gjendet përmes një kërkimi në internet dhe se në ofertë ekzistojnë dokumente të tjera.
- 2.33. Ashtu siç është elaboruar në lidhje me Lotin 4, kërkimi në Google nuk është katalog i prodhuesit dhe nuk mund ta plotësojë një dokument të paverifikueshëm. Po ashtu, certifikatat dhe autorizimi janë dokumente të veçanta dhe nuk e eliminojnë kërkesën e pavarur për katalogun e prodhuesit për secilin artikull. Prandaj, dokumentacioni i paraqitur për NEURO-SHEATH nuk dëshmon qartë konfigurimin e kërkuar të komponentëve dhe as nuk e identifikon në mënyrë të verifikueshme dokumentin si katalog të prodhuesit.

Loti 15 – Kompatibiliteti me telin udhëheqës 0.038”

- 2.34. Për Lotin 15, Dosja e Tenderit ka kërkuar kateter aspirues me madhësi 5–8F dhe ka përcaktuar shprehimisht se lumeni i brendshëm i kateterit duhet të mundësojë depërtimin e telit udhëheqës me diametër 0.038”.
- 2.35. Përmes përgjigjes së dhënë në Pyetjen nr. 4, Autoriteti Kontraktues ka lejuar që për madhësinë 5F diametri i brendshëm të jetë 0.50–0.58”. Ky sqarim ka ndryshuar vetëm kufirin e diametrit të brendshëm për madhësinë 5F dhe nuk e ka hequr kërkesën e veçantë për kompatibilitetin me telin udhëheqës 0.038”.
- 2.36. Në dokumentacionin teknik të paraqitur nga OE i rekomanduar nuk figuron dhe nuk është nënvizuar kompatibiliteti me telin udhëheqës 0.038”. Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar pretendimin duke arsyetuar se, nëse diametri i brendshëm i kateterit është 0.058”, atëherë teli me diametër 0.038” duhet të kalojë nëpër të. Për ta ilustruar këtë përfundim, Autoriteti Kontraktues ka përdorur analogjinë se një tavolinë me gjerësi 190 cm mund të kalojë nëpër një derë me gjerësi 200 cm.

Deshmi: Dok.nr.17 i bashkangjitur.

- 2.37. Ndonëse një analogji e tillë asesi nuk mund të merret për bazë si vlerësim profesional e aq më pak si vlerësim juridik i dokumentacionit të tenderit. Është me rëndësi të theksohet se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht kompatibilitetin me telin udhëheqës 0.038”, prandaj kjo karakteristikë është dashur të dëshmohet nga katalogu i prodhuesit. Nëse vetëm dallimi matematikor ndërmjet diametrave do të mjaftonte, atëherë nuk do të kishte qenë e nevojshme që kompatibiliteti të kërkohej si karakteristikë e veçantë teknike. Për më tepër, kompatibiliteti i një pajisjeje mjekësore me një pajisje tjetër nuk kufizohet domosdoshmërisht vetëm në mundësinë fizike që njëra të kalojë nëpër tjetrën. Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë që produkti të jetë teknikisht i përshtatshëm për përdorimin e paraparë dhe kjo përshtatshmëri dëshmohet vetëm përmes dokumentacionit të prodhuesit dhe asesi përmes përllogaritjeve matematikore.
- 2.38. Po ashtu, dokumenti teknik i paraqitur për Lotin 15 nuk përmban identifikim të qartë dhe të verifikueshëm të prodhuesit. Në të mungojnë emri dhe logoja e prodhuesit, adresa, faqja elektronike, kontaktet, numri i dokumentit, versioni apo revizioni dhe data e dokumentit, prandaj nga vetë dokumenti nuk mund të verifikohet se nga cili prodhues është lëshuar dhe cila është origjina e specifikimeve të paraqitura. Kjo mangësi nuk mund të plotësohet përmes kërkimit të produktit në “Google” ose duke iu referuar në mënyrë të përgjithshme dokumenteve të tjera të ofertës. Një faqe teknike pa identifikim të verifikueshëm të prodhuesit nuk duhet të trajtohet automatikisht në të njëjtën mënyrë si një katalog zyrtar dhe i identifikueshëm i prodhuesit. Fakti që ofertues të tjerë kanë paraqitur produkte nga prodhues ndërkombëtarë të identifikueshëm, përfshirë Terumo Neuro/MicroVention, ndonëse nuk është vetvetiu arsye për refuzimin e ofertës së OE-së së rekomanduar; çështja relevante këtu është që secili operator

ekonomik duhet ta dëshmojë në mënyrë të barabartë, të qartë dhe të verifikueshme produktin dhe karakteristikat teknike që ka ofertuar dhe asnjë kërkim në internet nuk mund ta zëvendësojë këtë. Prandaj, nga sa u tha më sipër, është e qartë se për Lotin 15 nuk është dëshmuar në mënyrën e kërkuar kompatibiliteti me telin udhëheqës 0.038” dhe as origjina e verifikueshme e dokumentit të paraqitur si katalog i prodhuesit.

Paverifikueshmëria e Dokumentacionit të Paraqitur si Katalog i Prodhuesit

- 2.39. Mungesa e katalogjeve të verifikueshme në këtë procedurë nuk është e kufizuar në një produkt të vetëm. Përkundrazi, mangësitë e tilla janë evidentuar në Lotin 4 për produktin NORO-CATH, në Lotin 14 për produktin NEURO-SHEATH dhe në Lotin 15 për dokumentin teknik të kateterit aspirues. Me një vështrim të thjeshtë të “broshurave” të paraqitura nga OE i rekomanduar për këto produkte vërehet qartë që mungojnë elementet që do mundësonin verifikimin e drejtpërdrejtë të prodhuesit dhe të dokumentit, përfshirë, sipas rastit, emrin juridik dhe identifikimin e prodhuesit, adresën, faqen elektronike, kontaktet, numrin e dokumentit, versionin apo revizionin dhe datën e lëshimit.
- 2.40. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur në Vendim ndonjë tabelë të plotë dhe të verifikueshme të porosisë, e cila do lidhte secilin kod pa ekuivok me prodhuesin, modelin, dimensionet dhe konfigurimin konkret të produktit të ofertuar. Në faqen për NEURO-SHEATH paraqiten kode si GC5F-STRKIT, GC6F, GC7F dhe GC8F, por vetëm paraqitja e këtyre kodeve si të vetme nuk e përmbushë këtë boshllëk përderisa dokumenti nuk e identifikon qartë prodhuesin dhe nuk e lidh kodin konkret me konfigurimin e kërkuar nga DT. Prandaj, Autoriteti Kontraktues ka qenë i detyruar të tregojë në ofertën origjinale se ku gjendet kjo lidhje dhe jo ta prezumojë atë.
- 2.41. Kërkesa 4 dhe Evidenca 4 e FDT-së kanë kërkuar shprehimisht katalogun e prodhuesit për secilin artikull të ofertuar dhe nënvizimin e specifikimeve teknike në të. Katalogu i prodhuesit, autorizimi dhe certifikatat janë kërkuar si dokumente të ndara dhe kumulative. Rrjedhimisht, ekzistimi i autorizimit ose i certifikatave nuk e korrigjon mungesën e identifikimit në dokumentin që është paraqitur si katalog dhe nuk dëshmon se përmbajtja e asaj faqeje teknike është lëshuar nga prodhuesi për modelin konkret të ofertuar.
- 2.42. Përpjekja për ta plotësuar këtë mangësi përmes “Google” e zhvendos gabimisht barrën e provës. Kjo pasi që asesi nuk është detyrë e komisionit vlerësues që, pas hapjes së tenderëve, të kërkojë në internet se cili subjekt mund të prodhojë një produkt me emër të ngjashëm dhe pastaj ta lidhë rezultatin e kërimit me dokumentin e dorëzuar. Detyrimi i OE-së ka qenë që brenda afatit të dorëzojë katalogun e prodhuesit dhe ta bëjë të verifikueshme përputhshmërinë e produktit. Në të kundërtën, Autoriteti Kontraktues nuk po sqaron një ofertë, por po e plotëson atë me të dhëna të mbledhura vetë jashtë ofertës. Prandaj, pranimi i këtyre dokumenteve si dëshmi e mjaftueshme, ndërkohë që nga operatorët e tjerë

është kërkuar katalog i identifikueshëm dhe me specifikime të nënvizuara, krijon standard të dyfishtë dhe është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, sic janë elaboruar më sipër.

Sqarimet e publikuara si pjesë e kushteve përfundimtare

- 2.43. Në Vendimin e datës 12 gusht 2026, Autoriteti Kontraktues deklaroi se sqarimet shitesë të kërkuara nga operatorët ekonomikë dhe të lejuara nga klinika “nuk përbëjnë kushte përfundimtare të vlerësimit”, por vetëm lehtësim dhe hapje të mëtejme të përshkrimeve teknike.
- 2.44. Theksojmë se ky konstatim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Dosjen e Tenderit. Pasi që pika 16.1 e tij përcakton se, kur si rezultat i një sqarimi është e nevojshme të ndryshohet Dosja e Tenderit, ndryshimi bëhet sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 17. Pastaj pika 17.2 përcakton shprehimisht se çdo shtojcë e lëshuar bëhet pjesë e Dosjes së Tenderit.
- 2.45. Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se sqarimet e tilla janë publikuar për ta “zgjeruar konkurrencën,” por nuk janë relevante gjatë vlerësimit të ofertave, është në vetëvete kundërthënëse. Kjo pasi që hapja e konkurrencës përmes lejit të parametrave të rinj ka kuptim vetëm nëse operatorët ekonomikë mund të ofertojnë sipas atyre parametrave dhe nëse përmbushja e tyre kontrollohet gjatë vlerësimit.
- 2.46. Vecanërisht problematik është fakti se ndryshimet janë kërkuar nga vetë OE i cili më pas është rekomanduar për kontratë. Autoriteti Kontraktues i ka pranuar kërkesat e tij për Lotet 2, 4 dhe 15, por pas hapjes së tenderëve ka deklaruar se ndryshimet e lejuara nuk përbëjnë kushte përfundimtare dhe ka pranuar përputhshmërinë edhe aty ku parametrat përkatës nuk rezultojnë nga dokumentacioni teknik i ofertës. Në këtë mënyrë, OE-së së rekomanduar i është lejuar fillimisht ndryshimi i kushteve për të mundësuar pjesëmarrjen e tij dhe më pas moszbatimi i plotë edhe i kushteve të ndryshuara.

Mungesa e arsytimit ligjor dhe faktik të Vendimit

- 2.47. Theksojmë se Vendimi i datës 12 gusht 2026 nuk përmbush kërkesat e Nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative as minimalisht. Kjo pasi që në Vendim janë kopjuar pjesë të konsiderueshme të pretendimeve të Parashtruesit të Kërkesës dhe janë dhënë përgjigje nga njësia kërkuuese, por nuk është bërë një analizë e detajuar e dokumenteve të tilla dhe bazës ligjore përkatëse.
- 2.48. Konkretisht, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar për secilin pretendim dokumentin e vlerësuar, faqen e katalogut, kodin e produktit, specifikimin e nënvizuar dhe arsyetimin juridik mbi të cilin një mangësi është konsideruar e parëndësishme ose e korrigjueshme. Në vend të kësaj, Vendimi përdor formulime si “nga përvoja jonë”, “është standard i përgjithshëm”, “lehtë mund të

vërtetohet”, “vetëm sa ta përshkruan emrin e produktit në Google” dhe analogji me derë dhe tavolinë.

- 2.49. Këto formulime, thënë më së lehti, nuk përbëjnë vlerësim të provave sipas standardit ligjor. Vlerësimi i një tenderi duhet të mbështetet në atë që operatori ekonomik ka dorëzuar dhe dëshmuar brenda afatit, e jo në atë që produkti mund të posedojë teorikisht, që komisioni mund ta dijë nga përvoja ose që mund të gjendet më vonë në internet.
- 2.50. Për më tepër, Vendimi është kundërtëhënës edhe në raport me katalogët e prodhuesit. Në njërën anë, Autoriteti Kontraktues deklaron se nuk i ka vlerësuar produktet në bazë të prodhuesit, ndërsa në anën tjetër Dosja e Tenderit e ka kërkuar katalogun e prodhuesit si provë të detyrueshme. Nëse dokumenti i paraqitur nuk mund të identifikohet si dokument i prodhuesit, atëherë nuk është përmbushur kërkesa për katalogun, pavarësisht se produkti ose prodhuesi mund të identifikohet përmes burimeve të tjera.
- 2.51. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues e ka përdorur dallimin në çmim si argument për ruajtjen e rezultatit të shpallur. Mirëpo një ofertë më e lirë nuk mund të shpallet fituese nëse nuk është e përgjegjshme. Pasi që përgjegjshmëria është kusht paraprak dhe i detyrueshëm, ndërsa çmimi është kriter që zbatohet vetëm pas përmbushjes së këtij kushti.
- 2.52. Nga sa u tha më sipër rezulton se mangësitë e evidentuara nuk kanë karakter të izoluar. Në Lotin 2 nuk është dëshmuar funksioni i rrjetës në formë filtri, kompatibiliteti me mikrokaterin 0.027” dhe bioabsorbueshmëria e produktit, ndërsa variacionet mbi të cilat OE e ka mbështetur kërkesën për ndryshimin e specifikimit nuk janë materializuar në ofertë. Në Lotin 4 dokumentacioni teknik paraqet konfigurime që nuk dëshmojnë përputhshmëri të plotë me gamën e lejuar dhe përmban konfigurimin 2.6–3.1F, i cili e tejkalon kufirin maksimal prej 2.8F, ndërsa broshura nuk e identifikon qartë prodhuesin. Në Lotin 14 nuk dëshmohet maja atraumatike e lakuar në formë J, nuk sqarohet përdorimi i të njëjtit TIGERTRIEVER në disa pozicione dhe nuk dëshmohet konfigurimi i kërkuar i setit NEURO-SHEATH. Në Lotin 15 nuk dëshmohet kompatibiliteti me telin udhëheqës 0.038” dhe mungon identifikimi i verifikueshëm i prodhuesit.
- 2.53. Këto mangësi përfshijnë parametra teknike të padëshmuar, konfigurime jashtë specifikimit, mungesë të varianteve mbi të cilat janë pranuar ndryshimet e Dosjes së Tenderit dhe dokumente teknike që nuk mundësojnë identifikimin e qartë të prodhuesit. Vecanërisht problematik është fakti se vetë OE i rekomanduar ka kërkuar ndryshimin e disa specifikimeve, Autoriteti Kontraktues i ka pranuar kërkesat e tij, ndërsa më pas përputhshmëria është pranuar edhe pa u dëshmuar plotësimi i parametrave të ndryshuar. Theksojmë se këto mangësi nuk janë formale dhe nuk mund të plotësohen pas përfundimit të afatit për ofertim.
- 2.54. Duke pasur parasysh natyrën profesionale dhe sensitive të pajisjeve objekt i këtij

aktiviteti të prokurimit, Parashtruesi i Ankesës kërkon që OSHP-ja të caktojë ekspert shqyrtues me njohuri në fushën e pajisjeve mjekësore neurointervente dhe radiologjike. Eksperti duhet ta administrojë ofertën origjinale elektronike të OE-së së rekomanduar, deklaratën për specifikimet teknike, katalogët me markimet origjinale, raportin e komisionit të vlerësimit dhe çdo sqarim eventual të kërkuar pas hapjes së ofertave. Vetëm përmes krahasimit të dokumenteve origjinale me specifikimet përfundimtare të Dosjes së Tenderit mund të konstatohet nëse produktet e ofertuar i plotësojnë kërkesat e detyrueshme.

- 2.55. Mbi bazën e argumenteve të paraqitura më sipër, të cilat dëshmojnë se oferta e OE-së së rekomanduar për kontratë është pranuar pa u vërtetuar plotësisht përputhshmëria e saj me Dosjen e Tenderit, Parashtruesi i Ankesës kërkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të marrë këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar Ankesa e AGS Corporation Sh.P.K., me numër unik identifikues 811859240 dhe me adresë në Dardania, Blloku 1, Hyrja 3, Nr. 5, 10000 Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material për stroke nga LE", me numër të prokurimit 220-26-4259-1-1-1 dhe numër të brendshëm 220-026-044-1-1-1, për Lotet 2, 4, 14 dhe 15.
- II. **ANULOHET** si i kundërligjshëm Njoftimi për Dhënien e Kontratës, i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, i datës 5 gusht 2026, për Lotet 2, 4, 14 dhe 15, në kuadër të aktivitetit të prokurimit "Furnizim me material për stroke nga LE" me numër të prokurimit 220-26-4259-1-1-1 dhe numër të brendshëm 220-026-044-1-1-1, dhe çështja kthehet në rivlerësim në përputhje me konstatimet e këtij vendimi pranë Autoritetit Kontraktues.
- III. **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues që, brenda afatit ligjor, ta informojë Organin Shqyrtues të Prokurimit për veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi, me paralajmërimin se mosrespektimi i tij do të trajtohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.
- IV. **LEJOHET** kthimi i tarifës së Ankesës në shumën e deponuar nga AGS Corporation Sh.P.K., në përputhje me Nenin 118, paragrafi 3 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e Autoritetit Kontraktues i kanë shkaktuar dhe vazhdojnë t'i shkaktojnë Parashtruesit të Ankesës dëme materiale dhe afariste, të cilat përfshijnë shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e tenderit, shpenzimet për sigurimin e tenderit, angazhimin e stafit profesional, teknik dhe administrativ, shpenzimet e procedurave për rishqyrtim dhe ankesë përkatësisht angazhimin e Avokatëve, rrezikimin e marrëdhënieve afariste me prodhuesit dhe partnerët

ndërkombëtarë, dëmtimin e reputacionit të kompanisë dhe humbjen e mundësisë për fitimin dhe realizimin e kontratave për katër lote me vlerë të përgjithshme të parashikuar prej EUR 613.000.00 €

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. *Ankesë e AGS Corporation Sh.P.K. kundër AK-SHSKUK*
2. *B05 Njoftim per Kontrat (2)*
3. *B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve (21)*
4. *Informata sqaruese-SHSKUK (1)*
5. *Kerkese per sqarime shtese 15.06.2026*
6. *Kerkesa per rishqyrtim SHSKUK 1*
7. *Vendim Mbi- Refuzimin e Kerkeses për Rishqyrtim 1*
8. *Kerkese per rishqyrtim Radiologji 2*
9. *Vendim Mbi- Refuzimin e Kerkeses për Rishqyrtim 2*
10. *Vendimi i AK (2)*
11. *Deshmia e pageses se tarifes per Ankesa ne OSHP*
12. *Lot 2 art. 1 Tigertriever*
13. *Lot 2 art. 4 Vascular closure device*
14. *Lot 4 Microcatheter*
15. *Lot 14 art. 1 dhe 2 Tigertriever*
16. *Lot 14 art. 3 Guiding cath kit*
17. *Lot 15 Aspiration cath*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

III. **OBLIGOHE**T Autoriteti Kontraktues që, brenda afatit ligjor, ta informojë Organin Shqyrtues të Prokurimit për veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi, me paralajmërimin se mosrespektimi i tij do të trajtohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik.

IV. **LEJOHE**T kthimi i tarifës së Ankesës në shumën e deponuar nga AGS Corporation Sh.P.K., në përputhje me Nenin 118, paragrafi 3 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e Autoritetit Kontraktues i kanë shkaktuar dhe vazhdojnë t'i shkaktojnë Parashtruesit të Ankesës dëme materiale dhe afariste, të cilat përfshijnë shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e tenderit, shpenzimet për sigurimin e tenderit, angazhimin e stafit profesional, teknik dhe administrativ, shpenzimet e procedurave për rishqyrtim dhe ankesë përkatësisht angazhimin e Avokatëve, rrezikimin e marrëdhënieve afariste me prodhuesit dhe partnerët ndërkombëtarë, dëmtimin e reputacionit të kompanisë dhe humbjen e mundësisë për fitimin dhe realizimin e kontratave për katër lote me vlerë të përgjithshme të parashikuar prej EUR 613,000.00€

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. Ankesë e AGS Corporation Sh.P.K. kundër AK-SHSKUK
2. B05 Njoftim per Kontrat (2)
3. B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve (21)
4. Informata sqaruese-SHSKUK (1)
5. Kerkese per sqarime shtese 15.06.2026
6. Kerkesa per rishqyrtim SHSKUK 1
7. Vendim Mbi- Refuzimin e Kerkeses për Rishqyrtim 1
8. Kerkese per rishqyrtim Radiologji 2
9. Vendim Mbi- Refuzimin e Kerkeses për Rishqyrtim 2
10. Vendimi i AK (2)
11. Dëshmia e pageses se tarifes per Ankese ne OSHP
12. Lot 2 art. 1 Tigertriever
13. Lot 2 art. 4 Vascular closure device
14. Lot 4 Microcatheter
15. Lot 14 art. 1 dhe 2 Tigertriever
16. Lot 14 art. 3 Guiding cath kit
17. Lot 15 Aspiration cath
18. Provat
19. Autorizimi i nenshkruar dhe i vulosur



***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.